**RREGULLORE**
**Nr. 2221, datë 18.7.2001**

**PËR NJË SHTESË NË RREGULLOREN NR.97, DATË 19.06.1996**
**"PËR LICENCIMIN E PERSONELIT FLUTURUES DHE TEKNIK"**

Në zbatim të nenin 102 pika 4 të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 "Për Aviacionin Civil Shqiptar" neni 33, Ministri i Transportit nxjerr këtë

RREGULLORE:

Në rregulloren e miratuar nga Ministri i Transportit me nr. 97, datë 19.06.1996, bëhet kjo shtesë:

Pas kapitullit X "Kërkesat mjekësore", shtohet një kapitull i ri XI me titull "Licenca e Dispecerit" , me këtë përmbajtje:

KAPITULLI XI
LICENCA E DISPECERIT

Në këtë kapitull janë përcaktuar rregullat dhe kërkesat për marrjen e licencës së dispecerit.

Çdo person aplikant për të marrë licencë e dispecerit duhet t'i nënshtrohet procedurave të mëposhtme.

Dispeceri gjatë kohës, që është në detyrë duhet ta mbajë me vete licencën, që e autorizon atë të kryejë këtë lloj shërbimi ose në mungesë të saj një dokument të lëshuar nga DPAC-ja, që e autorizon atë të kryejë një shërbim të tillë, vetëm në rastet kur ai është i shoqëruar nga një person tjetër, i cili ka një licencë të rregullt të lëshuar nga autoriteti për këtë lloj shërbimi.

Autoriteti lëshon një licencë të tillë, pasi të jetë i bindur që aplikuesi është një person i përshtatshëm për të mbajtur licencë, dhe është i kualifikuar në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje, për të vepuar në përputhje me licencën e lëshuar.

Çdo aplikant duhet t'i nënshtrohet ekzaminimeve, testeve, ku të evidentohen njohuritë, eksperienca dhe aftësitë individuale.

KËRKESAT

Kërkesat e mëposhtme parashikojnë lëshimin e licencës për të ushtruar profesionin e dispecerit në fushën e Aviacionit Civil.

1. MOSHA

Aplikanti të jetë në moshën mbi 21 vjeç.

2. NJOHURITË

Aplikanti duhet të demonstrojë një nivel njohurish të kënaqshme që të plotësojë kushtet e marrjes së licencës:

a) Të njohë rregulloret përkatëse të mbajtësit të licencës së dispecerit të fluturimit, sipas praktikave të shërbimit të trafikut ajror.

b) Të ketë njohuri të përgjithshme mbi avionin, principet e operimit, sistemet dhe instrumentet.

c) Të njohë limitet e operimit te avionit dhe fuqisë motorike të tij.

d) Të njohë listën minimale të pajisjeve.

e) Të njohë kalkulimet e kryerjes së fluturimit dhe procedurat e planizimit:

- efektet e ngarkesës dhe shpërdarjes së saj sipas karakteristikës së avionit gjatë fluturimit, dhe
- kalkulimet e masës dhe ballancës.
- të njohë planizimin e operimit të fluturimit;
- konsumin e karburantit dhe vazhdushmërisë së fluturimit;
- procedurat e zhgjedhura të aeroportit rezerv;
- kontrollin në rrugë-kalim si dhe rrezen e operimit;

f) Të përgatisë dhe plotesojë planin e fluturimit të shërbimit të trafikut ajror.

g) Të njohë parimet bazë të sistemit të planizimit të kompjuterizuar.

3. NË FUSHËN E METEOROLOGJISË

a) Të njohë meteorologjinë aeronautike;

- lëvizjen e sistemeve të presionit,
- strukturat e frontit,
- origjinën dhe karakteristikat e fenomeneve të kohës, të cilat influencojnë në fluturim dhe në procesin e uljes.

b) Të njohë interpretimim dhe aplikimin e raporteve meteorologjike aeronautike,

- hartat dhe parashikimet, si dhe
- kodet dhe procedurat për marrjen e informacionit meteorologjik.

4. NË FUSHËN E NAVIGIMIT AJROR

a) Të njohë parimet e navigimit ajror, duke iu referuar fluturimit me instrumente dhe vizual.

5. NË FUSHËN E PROCEDURAVE OPERACIONALE

a) Të njohë përdorimin e dokumentacionit aeronautik.

b) Të njohë procedurat operacionale për mbartjen e mallrave të zakonshme dhe të rrezikshme.

c) Të njohë procedurat e aksidenteve dhe incidenteve dhe procedurat e fluturimit të emergjencës.

d) Të njohë procedurat e ndërhyrjeve të paligjshme dhe sabotimeve, që mund të kryhen në avion.

e) Të njohë parimet e fluturimit sipas kategorisë së avionit.

6. NË FUSHËN E RADIOKOMUNIKIMIT

a) Të njohë procedurat e komunikimit me avionin dhe stacionet tokësore

7. EKSPERIENCA NË PUNË

a) Aplikanti duhet të ketë eksperiencë pune si më poshtë:

- 2 vjet shërbim në pozicionet e përcaktuara në pikat e mëposhtme;
- anëtar i ekuipazhit fluturues në transportin ajror;
- meteorolog në një organizëm të dispecerisë së avionit në transportin ajror;
- kontrollor në trafikun ajror ose supervizor teknik të zyrës së operimit të fluturimit të transportit ajror;
- 1 (një) vit asistent në dispecerinë e transportit ajror;
- të ketë përfunduar një kurs trainimi, të miratuar.nga DPAC-ja

Aplikanti, duhet të ketë shërbyer nën mbikqyrjen e një operatori fluturimi të paktën 90 ditë pune, brenda 6 muajve para aplikimit.

8. AFTESITË

Aplikanti duhet të ketë aftësitë e mëposhtme:

- Të bëjë analizën e motit, të përpiktë nga ana operative, nga seritë e hartave të përditshme të motit dhe të raporteve sinoptike.
- Të përgatisë një përmbledhëse të vlefshme operacionale të kushteve të motit në një zonë të një rruge ajrore specifike.
- Të bëjë parashikimin e tendecës së motit për transportin ajror, veçanërisht duke iu referuar aeroportit të destinacionit dhe rezervës.
- Të përcaktojë rrugën e fluturimit me optimale për një segment të dhënë dhe të përgatisë planet e fluturimit me dorë ose me kompjuter.
- Të kryejë supervizionin operativ dhe të gjitha asistencat e tjera për fluturimin në kushtet e motit aktual dhe të ndryshueshëm, sa më të përshtatshëm për detyrat e mbajtësit të një licence të operatorit të fluturimit

Kontrolli mjeksor, do të jetë çdo 24 muaj, në përputhje me regulloren e licencimit nr.97, datë 19.6.1996, sipas kapitullit 10.

9. TE DREJTAT E MBAJTËSIT TË LICENCËS DHE KONTROLLI I USHTRIMIT TË TYRE

Të drejtat e ushtrimit të licencës duhen të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në pikat 1.2.5 të këtij kapitulli. Të drejtat e mbajtësit të licencës së një operatori të fluturimit, duhet t'i shërbejnë cilësisë dhe përgjegjësisë për çdo zonë, për të cilën aplikanti duhet të zbatojë këto kërkesa të specifikuara në Aneksin 6 te ICAO-s

Aplikanti duhet të demostrojë aftësitë e tij në kryerjen e funksioneve të parashikuara në të drejtat e dhëna.

10. TESTIMI

Autoriteti mund, sipas gjykimit të tij, të përjashtojë ndonjë person nga testimi i kërkuar në qoftë se personi gjykohet nga autoriteti se ai posedon njohuritë e duhura ose aftësitë e nevojshme, sipas rastit, që mund të krijohet, në përputhje me rekomandimet e Aneksit 1 të ICAO-s.

Të gjitha testimet e kërkuara në këtë rregullore duhet të drejtohen nga autoriteti ose persona të autorizuar nga ai.

11.VLEFSHMËRIA E LICENCËS

Licenca e dispecerit të fluturimit lëshohet fillimisht për një afat kohor 24- muaj dhe rinovohet nga autoriteti pas mbarimit të afatit të vlefshmërisë së saj po me të njëjtin afat kohor.

Një aplikant për rinovimin e licencës duhet të plotësojë kërkesat përkatëse të kësaj regulloreje, duke bërë kërkesë me shkrim pranë DPAC-së, së bashku me një raport vlerësues të lëshuar nga punëdhënësi.

Në rastet e shkeljeve të procedurave të mësipërme, autoriteti rezervon të drejtën të kufizojë, pezullojë, ose të revokojë licencën e lëshuar.

Tarifat që aplikanti duhet të paguajë për marrjen ose rinovimin e licencës, përcaktohen në bazë vendimit të Këshillit të Ministrave nr.231, date 25.4.1995 “Për caktimin e tarifave të shërbimit dhe mënyrën e ndarjes së të ardhurave të tyre në fushën e Aviacionit Civil” .

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTEVE
**Viktor Doda**